


VLERAT MË TË MIRA



TË DEMOKRACISË

DEMOKRACIA ËSHTË LIRI

VENESA (10), ALBINA (10) RRON (11) ARBNOR (10) OMER (10) SHKURTA(9) AJLA (9), ANDI (10),
FATJON (10)

Nëse doni të mësoni më shumë për demokracinë, ju ftojmë ta lexoni artikullin tonë

Demokracia mbron të drejtat e njeriut. Por, cilat janë këto të drejta? Disa nga këto të drejta aq të rëndësishme janë: e drejta e argëtimit, e drejta e shkollimit, e drejta e punës e shumë të drejta të tjera. Ne sot e kemi kuptuar se demokracia është edhe liri. Po të mos ishte demokracia, ne sot nuk do të ishim këtu duke e shkruajtur këtë artikull. Kjo për shkak se demokracia na ka mundësuar që ne të shkollohemi. Përderisa ne shkojmë në shkollë dhe mësojmë, ne kemi mundësi të marrim pjesë edhe në Punëtoritë e Demokracisë. Ne sot kemi lëvizur lirshëm nga Vushtrria në Prishtinë dhe lirshëm do të kthehemi prapë në Vushtri, sepse ne jetojmë në një shtet demokratik, siç është Kosova.



Autorët e artikullit

Unë sot e kuptova që demokracia është kur vendi ku jetojmë na ofron mundësi shkollimi e argëtimi. Por, nëse dëshirojmë të mësojmë më shumë për demokracinë, atëherë mund të mësojmë në internet për të!



Fatjoni dëshiron të mësojë më shumë për demokracinë

Po Fatjon, të mësojmë më shumë në internet për demokracinë.



Shkurta dhe Andi dëshirojnë t'iu bashkangjiten Andit



Ne dëshirojmë që të mbretëroj paqja në botë



E drejta për të protestuar paqësisht

SHKRIMTARËT SHKRUAJNË PËR KUVENDIN


LAURESA (10), MUHAMED (10), BISLIM (10), AURON (10), DONIKA (13), ELONA (10), ERONA (10),
XHYLA (10)



Ne, nxënësit më të mirë, kemi vendosur t'iu tregojmë për një institucion shumë të rëndësishëm, që është Kuvendi. Ju lutem, na lexoni artikullin tonë

Përshëndetje të dashur lexues. Ne jemi shumë të gëzuar që kemi mësuar për Kuvendin. Jemi aq të gëzuar, sa që ne dëshirojmë t'iu tregojmë të gjitha gjërat që kemi mësuar për këtë temë. A jeni të gëzuar edhe ju që do të mësoni për Kuvendin? Ne po paramendojmë se ju po na thoni me zë të lartë: „Po!“ Kështu që ne po fillojmë duke treguar se Kuvendi ka 120 deputetë, të cilët i ka votuar populli. Por, sa vjeçar duhet të jenë qytetarët që të votojnë? Ata duhet të arrijnë moshën 18 vjeçare, në mënyrë që të dalin dhe të votojnë për kandidatin më të mirë.

Këta deputetë nuk janë vetëm shqiptarë, por ka edhe deputetë serbë, turq, ashkalinjë, goranë, egjiptianë, romë dhe boshnjakë. 100 nga deputetët janë shqiptarë, 10 janë serbë dhe 10 të tjerë janë nga këto komu-




nitete jo shumicë. Por, të gjithë janë kosovarë, ashtu siç jemi edhe ne.

Kuvendi ka 3 role kryesore. Njëri nga ta është roli përfaqësues, që do të thotë se deputetët janë me të vërtetë përfaqësues të popullit. Një tjetër rol është ai legjislativ, i cili do të thotë se Kuvendi është institucion ligjvënës. Në fund, kemi rolin kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon se si po punon Qeveria.

Sot ne mësuam edhe për rregullat. Njëjtë sikur Kuvendi, i cili bën ligjet për të gjithë shtetin, ashtu edhe ne kemi rregulla në shtëpi, në shkollë, por mund të kemi edhe në lagje, apo edhe në stërvitje. Ne nuk duhet të largohemi nga shtëpia kur luajmë dhe zbavitemi me shokët dhe shoqet në lagje, ne asnjëherë nuk duhet të bëjmë zhurmë në shkollë dhe ne duhet të jemi të mirë ndaj shoqeve dhe shokëve tanë.

Eduktorja jonë përveç se na mësoi për Kuvendin, na tregoi se si ne sot do të shkojmë ta vizitojmë atë. Mezi po presim të shkojmë në Kuvend!




Ligji i të drejtave të fëmijëve ka ardhur tek ne nga Kuvendi



Fëmijët në „Demos-ti“

E DREJTA E POPULLIT PËR TË VOTUAR

ERZA (10), LEONORA (9), DIJONITA (10), GENTRITA (11). VALENTINA (10), EDI (10), FATBARDH (10),
DONAT (10)



Se sa është e rëndësishme vota e popullit, do ta mësoni në artikullin që e kemi shkruajtur me shumë dashuri për juve, bashkëqytetarë

Ne jemi një grup i nxënësve të klasës së V-të, të cilët sot patëm rastin të mësojmë për sistemin demokratik dhe për të drejtën e qytetarëve për të votuar. Në grupin tonë të punës, kemi pasur një diskutim se çka do të thotë të zgjedhësh lirshëm. Ishim shumë të kënaqur kur mësuam se të gjithë e kemi të drejtën e votës, e cila na jep vlerë ne qytetarëve. Ne i kujtuam rastet e

trajtimit në mënyrë të barabartë i të gjithë qytetarëve na mundëson që të kemi harmoni dhe lumturi në jetën tonë. Tashmë, edhe ne jemi dëshmitarë të zgjedhjeve demokratike që do të mbahen në shtetin tonë. Jemi duke parë shumë emisione informuese dhe reklama të ndryshme lidhur me procesin zgjedhor. E tërë kjo po ndikon që ne si votues të së ardhmes të vetëdijësohemi për këtë proces kaq të rëndësishëm, i cili ndikon tërë qeverisjen e vendit. Është me të vërtetë kënaqësi në këtë moshë ta kuptosh rëndësinë e votës dhe fuqinë që ne veçse e kemi në duart tona. Këtë fuqi kur ta arrijmë moshën 18 vjeçare do ta kemi mundësinë ta shprehim duke votuar dhe kandiduar për ta udhëhequr vendin. Qytetarë të nderuar, ne aq shumë jemi befasuar nga fakti që vetëm një votë mund të bëjë ndryshim, sa që menduam shumë dhe vendosëm se kur të vijë koha, do ta përmbushin përgjegjësinë tonë për të votuar dhe për t'i zgjedhur personat më të mirë për zhvillimin e vendit.



Të barabartë edhe në procesin e votimit

mësuar edhe nga lënda e historisë, ku në kohët më të lashta shkeleshin të drejtat e njeriut. Këto raste nuk ishin aspak të mira dhe janë të papranueshme për ne. Prandaj, duke bërë krahasime në mes të sistemeve të ndryshme, erdhëm në përfundim se jemi me fat që jetojmë në një shtet me sistem demoraktik. Themi kështu, sepse e drejta për të zgjedhur na jep mundësi të shprehim mendimet dhe idetë tona lirshëm. Po ashtu,



Ne kemi të drejtë të votojmë që nga moshë 18 vjeçare

NE JEMI AKTIV

SELAUDIN (10), GETOAR (10), LORIK (10), ANXHELINA (11), ARJANITA (10), BLINERA (9), DRILON (10),
LEART (10)

Ne sot mësuam se aktiv nuk mund të jenë vetëm qytetarët mbi moshën 18 vjeçare. Aktiv ishim edhe ne sot, e do të vazhdojmë të jemi të fillë gjatë gjithë jetës

Sot ishte një ndër ditët më të bukura të jetës sonë. Kjo sepse ne sot mësuam rolin dhe rëndësinë tonë në vendin ku jetojmë. Natyrisht që ne si nxënës të klasës së V-të e dijmë rëndësinë e çdo qytetari. Mirëpo, sot e kishim rastin nga afër të shohim se çfarë ndryshimi mund të sjellë angazhimi i një qytetari të vetëm. Pasi që ne funksionuam si grup dhe jo si individë, ne edhe vendimet i morëm si grup. Por, ishte shoku ynë, Getoari, i cili na dha një ide se si mund të jemi qytetarë aktiv. Ai propozoi që të shtunën e ardhshme, ne nxënësit e klasës sonë të mbliidhemi dhe ta pastrojmë oborrin e shkollës. Sepse shkolla është shtëpia jonë e dytë. Është e drejta jonë të edukohemi, por e kemi përgjegjësi ta mirëmbajmë vendin tonë të dijes.



Ne shkëlqejmë porsì flori



Këtu jemi ne, grupi i qytetarisë aktive. Ashtu siç po e shihni edhe ju vetë të dashur lexues, ne sot ishim tej mase entuziast, sepse me anë të votimit të lirë, ne vendosëm që të shtunën e ardhshme ta pastrojmë shkollën tonë. Ne jemi aktiv!



Shoku ynë duke shkruajtur një porosi për të gjithë qytetarët

Tung, tung të dashur lexues, unë me këtë porosi dëshirojë t'iu bëjë me dije se asgjë nuk ka vlerë më të madhe se sa dashuria për atdheun. E pa dyshim që kur e don atdheun, punon në të mirën e tij, nuk e ndot atë e as nuk bën gjëra të pahijshme. Në fakt, kujdesesh gjithmonë që vendi yt të jetë sa më i zhvilluar. Ne sot, menduam në të mirën e atdheut, në të mirën e vendit tonë, në të mirën e Vushtrrisë. Ani pse ndoshta në moshë nuk jemi aq të rritur, ne sot vepruam si të fillë. Andaj, edhe ju të dashur bashkëmoshatarë, mendoni për vendin tuaj dhe punoni në të mirën e tij, sepse kur punoni në të mirën e tij, ju punoni edhe për vetveten.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mustafë Venhari“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-5
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri